

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBIJA		
Izdaje / Izlaze: Date / Dana: 07.05.2025		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 36	Nr. Faqeve. Nr. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.36
 Data: 30.04.2025

Në bazë të nenit 12 pika 12.1 dhe 12.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/15, Qershor 2008), dhe Nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR VËNIE NË KOSULTIM PUBLIK TË DRAFT PLANIT NDËRKOMUNAL PËR
 MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR KOMUNAT E GJILANIT,
 KAMENICËS, VITISË, NOVOBËRDËS, PARTESHIT, KLLOKOTIT, RANILLUG, FERIZAJ,
 KAÇANIK, SHTIME, HAN I ELEZIT, SHTËRPECË, KOSOVË.**

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr: 01.82/25 i datës 04.04.2025 për vënie në konsultim publik të Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunitet e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë, Kosovë.

II

Vëhet në konsultim publik Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunitet e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë, Kosovë.

III

Propozimet, sygjërimet apo vërejtjet eventuale paraqitën ditën e konsultimit publik, i cili do të caktohet në afatet e parapara ligjore, dhe njoftimi për konsultim publik do të paraqitet në veb faqen e komunës.

IV

Për këtë vendim do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike si dhe Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Khavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBILA		
Datëse / Izlaze: Date / Dana: 07.05.2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 37	Nr. Fajev. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.37
 Data: 30.04.2025

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 4, 44, 45, 46 të Ligjit Nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.Nr.815/2023 i datës 23.01.2025, Statutit të Komunës së Ferizajt me numër: 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01.NR.147 I DATËS 25.09.2017 PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2017-2025 TË KOMUNËS SË FERIZAJT

I

ANULOHET: Vendimi me numër: 01.NR.147 i datës 25.09.2017 me të cilin ishte miratuar Plani Zhvillimor Komunal (PZHK).

II

ARSYEJA e anulimit të këtij vendimi vije pasi që Gjykata e Apelit të Kosovës e ka shpallur të jashtëligjshëm me aktykim dhe i njeiti ka marr formën e prerë, Komuna në këtë rast është e detyruar që të harmonizoj aktet e saj me vendimet gjyqësore dhe legjisllacionin në fuqi.

III

Të gjitha dokumentet që janë hartuar si leje ndërtimi, pëlqime etj. para anulimit të këtij Plani Zhvillimor Komunal, mbasin në fuqi, dhe të njejtat nuk pezullohen.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do përkujdesen: Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit, Kuvendi dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
EJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLA		
Nese / Izdaje / Date / Dana: 07.05.2025		
Nr. Org. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 41	Nr. Faqeve. Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.41
 Data: 30.04.2025

Në bazë të dispozitave nenit 58 pika të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 30.04.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËS SË NGASTRES KADASTRALE 777-15 DHE 777-6 Z.K. DREMJAK PRONA PRIVATE, ME QËLLIM TË KËMBIMIT ME PJESËN E NGASTRES KADASTRALE 736-0 Z.K. DREMJAK, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I

Shpalljen Interes i Përgjithshëm - Publik pjesët e ngastreave kadastrale:

- 777-15 Z.K. Dremjak, me sipërfaqe prej 296 m², pronë e Raif Veselit dhe
- 777-6 Z.K. Dremjak me sipërfaqe prej 46 m², pronë e Raif Veselit.

II

Pjesa e ngastrës kadastrale 777-15 Z.K. Dremjak me sipërfaqe prej 290 m² pronë e Raif Veselit dhe pjesa e ngastrës kadastrale 777-6 Z.K. Dremjak me sipërfaqe prej 46 m² pronë e Raif Veselit Shpallen

Interes i Përgjithshëm - Publik me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale: 736-0 Z.K.

Dremjak 342 m² këto parcela shërbejnë për hapjen e rrugës "Veseli" në Fshatin Dremjak.

III

Pronat të cilat propozohen të këmbehen janë të regjistruara parcela 777-15 dhe 777-6 Z.K. Dremjak janë në pronësi të Raif Veselit, kurse parcela 736-0 Z.K. Dremjak është në pronësi të Komunës së Ferizajt.

IV

OBLIGOHET: Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkojë vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lart nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbim të këtyre njësive.

V

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLA		
Lloji i aktit: Data / Datë: 07.05.2025		
Nr. Org. / Org. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 42	Nr. Fajese / Br. Strana: 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.42
Data: 30.04.2025

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 4,5,6 pika 1.1 dhe nenit 14 pika 1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4,5 pika 1.2 dhe nenit 24 të Rregullores (qrk) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 51 të Statutit të Komunës së Ferizajt. 01.Nr.50 i datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFYTËZIM AFATSHKURTËR TË PJESËS SË
NGASTRAVE KADASTRALE 719-0 DHE 715-2,715-3,704-0,708-0 SI DHE 714-0
Z.K.CËRRNILLË.

I

Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër janë:

- 719-0 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 6695 m² (66 ari e 95m²)
- 715-2 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 10000m² (1ha.00 ari e 00m²)
- 715-3 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 10000m² (1ha.00 ari e 00m²)
- 704-0 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 2556 m² (25 ari e 56m²)
- 708-0 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 2124 m² (21ari e 24m²)
- 714-0 Z.K.Cërrnillë, vendi i quajtur "Llozinë" me sipërfaqe prej 1188m² (11 ari e 88m²)

II

Çmimi fillestar është 150.00€, çmimi është mujor, fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë.

III

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi është rritja e të hyrave për Komunën e Ferizajt.

IV

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në vendim është afatshkurtër, në periudhën deri 15 vjet.

V

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër.

VI

Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim bëhen përmes konkurrencës, ankandit të hapur publik.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi